REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ

KËSHILLI I BASHKISË

Datë 10.02.2026 Prot.51 (pesëdhejtëenjë)

Protokoll nr. 51

I mbajtur sot më datë 10.02.2026, në mbledhjen e jashtë radhe të Këshillit Bashkiak Maliq, në sallën e mbledhjeve të këshillit të bashkisë, ora 10:00.

Rend Dite:

1-Pika e parë është hapja e mbledhjes dhe realizimi i korumit.

2-Pika e dytë është deklarimi i konfliktit të interesit nga këshilltarët për vendimarrjen lidhur me çështjet e rendit ditës.

3- Pika e tretë është. Projektvendim për detajimin dhe përdorimin e fondit për mbrojtjen civile nga fondet e veta

Këshilltarë të pranishëm në sallë:

Ornildi Demollari; Pranvera Begolli; Petrit Kupe; 3(tre)

Këshilltarë të pranishëm në paltformën messenger: Faslli Zholi; Eglantina Balli; Yllson Ibrahimllari; Aramando Dautllari; Lulëzim Hoxhaj; Ornildi Demollari; Idlir Limllari; Enida Avdolli; Danjela Ibrahim; Gentiana Drabo;Marinathi Avrami;Kristina Malelli; Eglantina Balli; Klea Baçi; Andonaq Risto; Albina Xhejo; Rovena Terolli; Dritan Çami 17(shtatëembëdhjetë) këshilltarë.

Të pranishëm nga Administrata: Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu;

Ornildi Demollari:Përshëndetje, ju lutem bashkojuni mbeldhjes, nuk po bëjmë dot lidhjen në (ZOOM), kalojmë në platormën messenger.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Komanda Mbështetës e Forcave të Armatosura ve në dispoziocion mjetet dhe ne si bashki do mbulojmë shpenzimet.Në realcion ju kemi sqaruar.Nëse ka ndonjë pyetje.

Ornildi Demollari: Kemi thirrur këtë mbledhje jashtë radhë të Këshillit të Bashkisë Maliqit me kërkesë të Kryetarit të Bashkisë, Zotit Gëzim Topçiu. me rend dite prej tre pikash. Pika e parë është hapja e mbledhjes dhe realizimi i korumit. Pika e dytë është deklarimi i konfliktit të

interesit nga këshilltarët për vendimarrjen lidhur me çështjet e rendit ditës. Pika e tretë është. Projektvendim për detajimin dhe përdorimin e fondit për mbrojtjen civile nga fondet e veta. Mbledhjes janë bashkuar gjithsej shtatëmbëdhjetë këshilltarë.miratohet Rendi i ditës.Të cilët kanë miratuar rendin e ditës dhe ndërkohë janë duke votuar edhe pikat e rendit të ditës. Jemi tek pika e tretë e rendit të ditës, që është projektvendimi me numër tre për detajimin dhe përdorimin e fondit. Është fjala për një bashkëpunim me forcat e armatosura të Republikës së Shqipërisë. Riparimin e dëmtimeve në rrugën e fshatrave Osojë-Kodras në njësinë administrative Moglicë, pasi në këto fshatra, nga reshjet e nëntorit dhe të dhjetorit, pati dëmtime në rrugën lidhëse të fshatrave. Siç thashë, janë duke votuar këshilltarët pikën tre të rendit të ditës dhe nga sa po shoh gjatë votimit. Nga votimi, po shoh se po miratohet pika 3 e ditës me 16-17 vota pro. Faleminderit.

Mbajtës Protokolli

SEKRETARI I KËSHILLIT

Gertjan GJIRITI

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI